

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	"Janë bërë gabime të rënda ligjore", avokatët e Thaçit do të apelojnë vendimin e Hagës: Thirrje për qetësi në Kosovë
ADRESA	https://a2news.com/rajoni-bota/kosova/aktualitet/avokatet-e-thacit-do-te-apelojne-vendim-in-e-hages--i1185305
BURIMI	a2news.com
GJENDJA	edited

KOHA


KAPUR NGA NE	17 shtator 2026, 17:29:24 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	17 shtator 2026, 17:26:00 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	5a5d5d00725b981726eb473e0f53df4f630f4903a1f778a98a0ecbb7230d0833
TEKSTI	5b70ac46acee7745656e1479e73dc5f876ea7fc1548a6d43f79f7b2cc1b7feaf
PAMJA	ac676899e10336161f12938772dc5c73fc6ba3bb9760c469790f5b7c0dee3d0c

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	a954d5c7dce653c42c6f6f103247cfeda5e9402089a5ce74556354391f9358d0
E MËPARSHMJA	cadb1fccb55e9030000598f42f5abc6b84da08e52bcc764eaaa65a91965428e8
RRËNJA MERKLE	a0e62f20f1566f1a6ab80e6e4e50c1c4744bc54a84695e6ceb27bc326e386c4d
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

https://scan.stamles.eu/verify/a954d5c7dce653c42c6f6f103247cfeda5e9402089a5ce74556354391f9358d0


PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

"Janë bërë gabime të rënda ligjore", avokatët e Thaçit do të apelojnë vendimin e Hagës: Thirrje për qetësi në Kosovë

Nga A2 CNN
17 Shtator 2026, 19:26 | Aktualitet



Një ditë pasi gjykata e Hagës dënoi me 81 vite burg 4 ish-krerët e UÇK-së, ka ardhur edhe reagimi i avokatit të Hashim Thaçit. Në një postim në rrjetet sociale avokatët e ish-presidentit të Kosovës, kanë njoftuar se do të apelojnë vendimin e fundit të Dhomave të Specializuara të Kosovës, duke pretenduar se gjatë procesit gjyqësor janë bërë gabime të rënda ligjore, faktike dhe procedurale.

Përmes avokatëve, Thaçi shpreh mirënjohjen për mbështetjen nga qytetarët dhe komuniteti ndërkombëtar dhe u bën thirrje qytetarëve të Kosovës që të ruajnë qetësinë pas vendimit të djeshëm.

Mbrojtja pretendon se procesi është zhvilluar me mungesë paanshmërie dhe se konstatimet për fajësi janë mbështetur në prova të pamjaftueshme.

Sipas mbrojtjes, apeli do të fokusohet në shkeljet e pretenduara të së drejtës për një proces të drejtë gjyqësor, të garantuar nga Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe Kushtetuta e Kosovës. Thaçi ka mohuar çdo përfshirje në vrasje dhe kërkon rishqyrtimin e çështjes nga Gjykata e Apelit.

Postimi i plotë i avokatit të Thaçit në X:

Hashim Thaçi dëshiron të shprehë mirënjohjen e tij të sinqertë për mbështetjen e jashtëzakonshme që ai, Kadri Veseli, Rexhep Selimi dhe Jakup Krasniqi kanë marrë nga qytetarët e Kosovës dhe nga komuniteti ndërkombëtar. Ai u bën thirrje qytetarëve të Kosovës që të ruajnë qetësinë në reagimin e tyre ndaj padrejtësisë së djeshme.

Avokatët e zotit Thaçi do ta apelojnë aktgjykimin e djeshëm të Trupit Gjykues pranë Panelit të Gjykatës së Apelit të Dhomave të Specializuara të Kosovës (DHSK), duke pretenduar se janë bërë gabime të rënda ligjore dhe faktike, të cilat kanë cenuar drejtësinë e procesit gjyqësor.

Gjatë gjithë gjyqimit, Mbrojtja ngriti në mënyrë të përsëritur shqetësime lidhur me drejtësinë procedurale, përfshirë shtrirjen e gjerë të pyetjeve të drejtpërdrejta të bëra nga anëtarët e Trupit Gjykues, në një mënyrë që nuk krijonte përshtypjen e paanshmërisë. Mbrojtja vlerëson se ndërhyrjet e gjyqtarëve e kapërcyen kufirin e kërimit neutral të së vërtetës, duke cenuar përshtypjen e paanshmërisë që kërkohet sipas standardeve ndërkombëtare të drejtësisë. Kjo mungesë paanshmërie tashmë përshkon edhe aktgjykimin e Trupit Gjykues.

Mbrojtja parashtro se konstatimet e Trupit Gjykues për fajësi nëntai dëshimit të

TE FUNDIT

Sot Europa League me 9 sfida. Vëmendja te Juventusit, në fushë Real Sociedad-Bournemouth

"M'u duk mizori ndaj Thaçit", ish-hetuesja e Millosheviçit: Ndihej në krijimin e kësaj gjykate kur ishte President

Ish-hetuesja e Millosheviçit: Haga nuk u krijua kurrë për të dhënë drejtësi

"Do të humbasë Evropa, jo Turqia", Erdogan: BE-ja nuk është më prioritet për Ankaranë

MË TË VIZITUARAT

Haga unifikon Tiranën, krah Prishtinës deklarata e Kuvendit: Nuk rishkruhet h...

Nis Europa League, Milan mundet nga benfica në shtëpi, fiton Bayer Leverkusen

Prej 4 ditësh në arrati dhe në kërkim nga policia greke, Alket Rizai dyshohet...

LIVE UPDATES

Mbretëria e Bashkuar paralajmëron paketë të re sanksionesh ndaj Rusisë

LIVE | Gjithçka rreth Samitit Ukrainë-Europa Juglindore

Blinken në Tiranë, vizita e Sekretarit Amerikan të Shtetit në Shqipëri

...nëse paktet e marrëveshjes së Trupit Gjykoës për njëse përfaqësojnë të arsyeshëm mbështeten në prova të pamjaftueshme dhe të pakonfirmuara nga burime të tjera. Për më tepër, Trupi Gjykoës deklaroi dhe publikisht se zoti Thaçi ishte i përfshirë në vrasjen e Behajdin Allaqit, pasi më parë kishte urdhëruar të gjitha palët në këtë çështje që të mos e diskutonin rastin e zotit Allaqi në seancë publike dhe kishte urdhëruar që të gjitha provat që lidheshin me këtë rast të mbaheshin konfidenciale.

Në këtë mënyrë, Trupi Gjykoës e ka shpallur publikisht zotin Thaçi fajtor për një vrasje, ndërkohë që provat mbi të cilat e ka mbështetur këtë përfundim i ka mbajtur të fshehura nga shqyrtimi publik. Zoti Thaçi do ta mirëpriste një shqyrtim të tillë publik të provave. Mbrojtja do t'i apelojë vendimet e Trupit Gjykoës për shkeljen e të drejtave të tij themelore për një proces të drejtë gjyqësor, të garantuara nga Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe Kushtetuta e Kosovës. Zoti Thaçi mohon shprehimisht çdo përfshirje në vrasje.

Respektimi rigoroz i standardeve të drejtësisë procedurale është thelbësor për ruajtjen e besimit të publikut tek institucionet ndërkombëtare të drejtësisë penale. Mbrojtja do ta dorëzojë zyrtarisht Njoftimin për Apel, me qëllim korrigjimin e këtyre gabimeve faktike, ligjore dhe procedurale nga Paneli i Gjykatës së Apelit.

(A2 Televizion)

A2 CNN **Livestream**

MUND TE LEXONI GJITHASHTU



“Haga i dha Vuçiçit armën më të fortë”, Tromp: Gjykata u krijua për të kënaqur Serbinë, dënimi për Thaçinin mizori



Aktgjykimi i Hagës përballë historisë së luftës së Kosovës



“Gjykata që dënoi Thaçinin do dënonte dhe George Washingtonin”, flet njeriu që bombardoi Serbinë



“Çka s'mund ta mbajë guri, e mban njeriu”, djali i Jakup Krasniqit mesazh prekës pas dënimit të të atit me 25 vite burg



"Liria ka emër", Dua Lipa reagon pas vendimit të Speciales për dënimin e ish-krerëve të UÇK



Nazarko: Serbia do që protestuesit të përplasen me EULEX-in

Latest Videos



Lavrov kërcënon Europën: Nëse sulmoni Rusinë lufta tjetër do të jetë shumë e shkurtër



Bojkotohet mësimi, mikrobuzi me 20 vende për 45 nxënës dhe mësues



"Janë bërë gabime të rënda ligjore", avokatët e Thaçit do apelojnë vendimin, apel për qetësi



PS nuk heq dorë nga varianti i saj për pagat e magjistratëve, e kalon në seancë

Shqipëria

Aktualitet
Kronikë
Politikë
Ekonomi
Sociale
Kulturë
Moti

Kosova

Kulturë
Sociale
Ekonomi
Politikë
Kronikë
Aktualitet

Rajoni & Bota

Balkani
Bota

Argëtim

Showbiz
Lifestyle
Kapur në kamera
Teknologji

Sport

Live Euro 2024
Futboll
Sporte të tjera

Speciale A2

5 gjëra në 5 minuta
A2 CNN në Izrael
31 Minuta
A2 CNN në Ukrainë
Lumi i kokainës
Ditari ndërkombëtar
Zbulohet
Imagjinatë
Dëshmi



Live TV

Rreth nesh Kushtet e Privatësisë Karriera Kontakt

© 2023 A2 CNN / G2 Media shpk
All Rights Reserved.

Mundësiuar nga Mediadesk